



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM LEZHË

Nr. 84 Prot

Lezhë më, 05.10.2023

Lënda: Njoftim mbi datën e vleresimit profesional dhe intervistës nga Këshilli I Gjykatës për procedurën e ngritje në detyrë, në kategorinë drejtuese, pozicionin “Shef/e Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë”, dhe pozicionin “Shef/e Sektori i Protokollit dhe Arkivës”;

KESHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Adresa: Godina “Poli i Drejtësisë”,
Rr. “Ana Komnena”
Tiranë

Bazuar në Ligjin Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH”, vendimit Nr.622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, neni 9, udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe referuar njoftimit nr.785 Prot, datë 07.09.2023, për shpalljen e procedurës së “lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” në kategorinë drejtuese”, për pozicionin “Shef/e Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë”; “, kategoria III-2, dhe për pozicionin “Shef/e Sektori i Protokollit dhe Arkivës” kategoria III-2, brenda afatit dt. 28.09.2023, janë paraqitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë përkatesisht këto kërkesa:

1. **Daniela Vulaj aplikim për pozicionin “Shef/e Sektori i Protokollit dhe Arkivës”**
kërkesë dt.27.09.2023
2. **Adelina Dedgjonaj aplikim për pozicionin “Shef/e Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë”**
kërkesë dt.28.09.2023.

Të dy këto aplikante pas verifikimit paraprak, rezultuan që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta dhe të përgjithshme sipas kërkesave të procedurave përkatese të shpallura.

Në këto rrethana Bazuar në nenin 17 e 19 të vendimit nr.622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për procesin e plotësimit të vendeve të lira nëpërmjet procedurës së “lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, procedura për ngritjen në detyrë do të vazhdojë me vlerësimin profesional që do të zhvillohet nga Këshilli i Gjykatës me dt. **06.10.2023 ora 14.00** ne ambientet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Kancelare e Gjykatës
Ardiana Krasniqi

